

TÜV NORD CERT – Certifikim ne FSC® Zinxhiri i Produktit

Ndryshim vlerash ne Printim, Lende drusore, Mobileri e Produkte letre

Te Pergjithshme

Gjykimet e vlefshme te konsumatoreve dhe klienteve te biznesit ne lidhje me printimin, lenden drusore dhe produktet e letres jane duke ndryshuar. Produktet me prejardhje nga pyje me manaxhim te pergjegjshem, kane rritje te larte ne kerkesa.

Objektivi

Qendrueshmeria pergjate gjithe zinxhirit te prodhimit eshte kriter vendimtar per kete. Kjo gjithashtu perfshin mbrojtjen e zones se pyllezuar, popullsine e cila varet nga pyjet, te gjithe punonjesit e perfshire dhe aspektet e ruajtjes/mbrojtjes se natyres. Kompania e cila deshirojne te importojne lende drusore, pulpe ose produkte letre ne BE, duhet te provoje se produktet e saj prodhohen ne rruge ekskluzivisht ligjore dhe nga burime te lendes se pare me origjine te padiskutueshme.

Prove e e paanshme e Pylltarise se Qendrueshme dhe e Pergjegjesise Sociale

Organizata e pavarur jofitimpruresse Keshilli per Mbikqyrjen e Pyjeve® (FSC) ka hartuar standardet per pylltari te qendrueshme, te pergjegjshme per shoqerine dhe mjedisin. Per Certifikimin "Zinxhiri i Ruajtjes" (CoC) ne FSC® eshte marre parasysh gjithe zinxhiri i produktit nga pylli deri ne konsumatorin e fundit . TÜV NORD CERT eshte i akredituar nga FSC® si nje organizem nderkombetar certifikimi dhe certifikon zinxhirin e produktit sipas Standarteve FSC®. Produktet qe permbushin kerkesat e standartit FSC® mund t'u jepet e lejohet perdorimi i logos FSC®.



Kompanite qe mund te Certifikohen

Ky certifikim eshte i pershtatshem per impiantet e sharrave, tregtaret e drurit, prodhuesit e mobiljeve, prodhuesit e letrave, botuesit, shtypshkronjat, prodhuesit e ambalazheve me leter, prodhuesit e shoper-ave (cantave) prej letre dhe te gjitha kompanite e tjera qe ofrojne produkte te prodhuara nga druri ose fibra druri.

Certifikimi lidhet ne vecanti me fazat e meposhtme te zinxhirit te furnizimit:

- Blerja
- Perpunimi
- Magazinimi
- Shitje

Kushtet per t'u Certifikuar

- a- Asnje perzierje e lendes drusore FSC® me lende drusore te pakontrolluar;

TÜV NORD CERT – Certifikim ne FSC® Zinxhiri i Produktit

Mbi bazen e Certifikimit të Suksesshem të zinxhirit të produktit, timbri (logo) mund të identifikohet qartë në çdo kohë dhe në të gjitha fazat e prodhimit, perpunimit dhe të marketingut. Kjo ju jep ju dhe partnerëve tuaj në treg, avantazhe të qarta në:

- Ju merrni leje për të përdorur logon brenda 24 orëve ose një sugjerim korrekтив nga grupi ynë i eksperteve mbi modelet e printuara që ju dorezoni për shqyrtim.
- Përmes përdorimit të logos së mirënjohur FSC® ju mund të dalloheni si furnitor me cilësi nga konkurrentët tuaj të cilët nuk e gëzojnë këtë Certifikim.
- Ju përmbushni kriteret paraprake në përputhje me kërkesat e BE.
- Transparenca në rrjedhjen e perpunimit nga pyjet tek konsumatorët.
- Besueshmëri përmes Certifikimit në përputhje me standartet e mirënjohura globalisht.
- Verifikim të perkushtimit tuaj ndaj mjedisit dhe sjelljes etike.
- Pranimit nga Klientët dhe Konsumatorët të cilët i japin shumë rëndësi provës së origjinës së përgjegjshme të produktit.
- Përthithje e grupeve të reja të konsumatorëve që kanë një politikë blerjeje Green (pro-mbrojtjes së Mjedisit).

Certifikimi i kombinuar ose i grupit sipas Standartit FSC® CoC mund të përdoret në mënyrë të përbashkët nga firmat e organizuara në një nivel më të lartë (p.sh. sistemet e bashkëpunimit Kooperativ ose të franchising/franshizes).

Kompanitë e perpunimit të drurit që kërkojnë këtë markë, në përgjithësi përballen me parë me sistemet e certifikimit. Si p.sh., certifikatat e sistemit të manaxhimit sipas ISO 9001, ISO 14001 ose ISO 50001 dhe

- PEFC
- Blue Angel

- b- Verifikime sasie/sisteme të kontrollit të inventarit për produktet e blera, magazinuara dhe prodhuara me Certifikimin FSC®;
- c- Përputhja me përshkrimin e Procesit të Punës;

Rruga e ndjekur për t'u Certifikuar

1. Kompania Vendosi për t'u Certifikuar FSC® COC
2. Kerkoni formularin, plotesoni te dhenat e kompanise
3. Faza e Ofertes dhe Kontrates
4. Porosit Certifikimin (fakultative: një para-audit fillestar)
5. Sebashku me TNC: Specifikoni datën e auditit me Manaxherin e FSC® dhe koordinoni planin kohor
6. Audit në Kompani mbi pikat kyçe të sistemit të kontrollit, konfirmim të marrjes/shpërndarjes së produkteve nga furnitorët, ndarja dhe dallimi mes produkteve të Certifikuara dhe ato të pa-Certifikuara, etiketimi i produkteve, sasitë dhe produktet në dalje, proceset e kompanisë, dokumentimi, eficaenca e sistemit.
7. Në rast të devijimeve nga standarti të cilat janë për plotesim në vazhdim, krijohen para-kushtet e reja për kompaninë.
8. Raport mbi rezultatet e auditit, rekomandimet për Certifikimin e secilës pjese të zinxhirit të produktit.
9. Nëse vlerësimi është pozitiv, leshohet Certifikimi FSC® për pjesët e audituara të zinxhirit të produktit (vlefshmeria 5-vjet), regjistrim në databazën e FSC®, logo e aprovuar brenda 24-orëve.
10. Audite Vjetore për inspektim në ambientet e prodhimit.

TÜV NORD CERT – Certifikim ne FSC® Zinxhiri i Produktit

- Carbon Footprint
- BRC IOP

Me ekspertizen e saj te gjere, TÜV NORD CERT mbulon nje game te gjere te zonave te Certifikimit nga nje burim i vetem. Aty ku certifikimi kryhet sipas me shume se nje Sistemi (auditime te kombinuara) ka efekte sinergjie te rendesishme qe rezultojne ne kursime te medha ne kosto.

TÜV NORD CERT eshte nje Ent Prestigjioz Nderkombetar i njohur dhe Partner i Besueshem per sherbimet e inspektimit dhe certifikimit. Ekspertet tane dhe auditoret zoterojne njohuri te thella. Kjo garanton pavaresi, neutralitet dhe vazhdueshmeri kur jane duke siguruar mbeshtetje per klientet tane. Avantazhi per ju eshte i qarte: Auditoret tane shoqerojne dhe mbeshtesin zhvillimin e kompanise suaj dhe ju ofrojne feedback objektiv per permiresim.



Further information and an overview of all locations can be found at www.tuev-nord-cert.com

TÜV®



TÜV NORD CERT GmbH

Phone: +355 6920 31015

E-mail: epazaj@tuv-nord.com

Rep. TÜV NORD Albania: Mr. Elvis PAZAJ